

VALTER MEMISHA

VLERA ARTISTIKE E FRAZELOGJISË NË POEZINË
E ALI ASLLANIT

Ali Asllani përveçohet në historinë dhe kulturën tonë kombëtare me prurje të shumëfishta, duke zënë vend të vlerësuar me krijimtarinë e tij letraro-artistike. Sipas studiuesit B. Gaçe ai “është pa dyshim ndër personalitet më të shquara të poezisë shqipe, sidomos në vitet pas periudhës së Pavarësisë Kombëtare e në kohët e vona. Ai hyri në letërsinë shqipe si një rilindës i vonë. Zëri i tij poetik u shfaq i plotë në vitet ‘20 - ‘30”¹ të shekullit të kaluar. Sipas këtij studiuesi “poezia e Ali Asllanit shquhet për origjinalitetin dhe autencitetin e zërit të vet. Është një poet i veçantë, një zë tjetër i bukur, që i bashkohet korit të përgjithshëm, poezisë së vërtetë të atëhershme shqiptare”².

Poezia e tij, më shumë se te cilido krijues tjetër në letërsinë tonë, ka brumë dhe vlagë nga gjuha e popullit. Këtë vlerësim e mbështetim në pasurinë frazeologjike popullore që ka ditur ta njohë me thellësi dhe ta përdorë me art. Theksojmë këtu se poezia, si lloji i krijimtarisë artistike ka “kapriçiot” e veta dhe krijuesi i saj gjendet në vështirësi në përzgjedhjen e përdorimit artistik të fjalës dhe jo më të njësisë frazeologjike, e cila, duke qenë e ndërtuar me dy a më shumë fjalë shënuese “nxjerr kleçka”, në rrafshin semantik, në rrafshin e realizmit metrik të vargut apo të realizimit të figurshmërisë, si tipar kryesor i saj. I mëshojmë këtij aspekti, sepse njësia frazeologjike është në vetvete një produkt i shndërrimit të figurshëm, përgjithësisht, të një sintagme / të një togfjalëshi të lirë.

Ky punim bën objekt trajtimi pasurinë frazeologjike të vëllimit “Vidi - vidi pëllumbeshë”, një përmbledhje me poezi të përzgjedhura nga krijimtaria e poetit. Që në leximin e parë të befason numri i madh i njësive të tilla. Thënë ndryshe duket sikur **kemi një fjalor frazeologjik të poetizuar**. Në një vëllim të formatit të vogël, me rreth 250 faqe me poezi, gjen rreth 1000 njësi frazeologjike. Ne kemi qëmtuar mbi 650 njësi të tilla (saktësisht 655), duke synuar që këtu njësitë të jepen vetëm njëherë, përmes një ilustrimi, sepse një pjesë jo e vogël e tyre dalin disa herë në poezi e në ndërtime të ndryshme.

1. Për krijimtarinë e A. Asllanit janë bërë me dhjetëra studime, të pjesshme a të plota. Ne nuk mëtojmë të rindalemi në vlerat e saj tematike, ideore, artistike, estetike etj., por po ravijizojmë diçka, sidomos për fushat konceptore, që identifikohen përmes frazeologjisë, duke i lënë vendin qendror pasqyrimin të pasurisë së vjelë.

¹ B. Gaçe, *Ali Asllani liriku i madh i poezisë shqipe*, në A. Asllani, “Vidi-vidi pëllumbeshë!”, Botime Toena, Tiranë, 1999, f. 261.

² Po aty, f. 261.

a. Në poezi gjen njësi frazeologjike që të lidhin me mjedisin qytetar vlonjat: *Thon' se shiu muajt maj / nëpër dete bën sedefe / dor' e vajzës punon paj', / dor' e majit bën gjergjefe!*; *Një i ri, një këngëtor, / ju pat thurur një tuf' këngë, / po atje në atë Vlorë, / ja kish bërë koka dëng!*

b. Aty gjen, gjithashtu, njësi frazeologjike që të lidhin me mjedisin e fshatit, me jetën baritore etj., dhënë drejtpërdrejt a përmes frazeologjisë së motivuar nga bota e kafshëve dhe e bimëve: *Erdhi vera përsëri / kalipeç mbi shtiza dielli, / bejk' e stanit buz' flori / del e pret me kënga fyelli!*; *Rrymë e frymë farmak çakalli, / fund e krye duhen çdukur / ndryshe bëhet byk në lëmë / tej përtej kjo botë e bukur!*; *Po nashti na humbi vula, / dualnë zogjtë nga furriku / dhe këto të reja pula / u bën gjela tash, kikiku!*; *Me dorë shkence tej për tej / u bë vashëz dhe vejushka, / s'është' çudi që nesër – dej / të na pjelli edhe mushka!*; *I ka hije detit vala, i ka hije kalit shala, / po më shumë nga të gjitha, i ka hije burrit fjala!*; *I ka hije detit vala, i ka hije kalit shala, / po më shumë nga të gjitha, i ka hije burrit fjala!* etj.

c. Vend të veçantë në poezinë e Ali Asllanit zë njësitë frazeologjike që lidhen me temën patriotike, sidomos me mjedisin luftarak e me ngjarjet e Luftës së Vlorës në vitin 1920 etj: *Erdhën rrotull e vërdallë, / po e pan' që s'bëhej ballë!*; *Kur e pa i gjithë mileti / që do bëhej kiameti; Gjith armiqve gjer' e thellë, / t'u vej flaka gjer në qiellë!*; *S'shitet Vlora me fermane, / s'vishet burri me tumane; Si thot' beu që don paqe, / posht' mësalla me dy faqe!*; *Nuk e ka shqiptari fisë / që të thith' nga dosa sisë!*; *E pra fjalën e ka Vlora / ta bëj' botën plotë dora...; Nuk e ka shqiptari fisë / që të thith' nga dosa sisë!*; *E pra fjalën e ka Vlora / ta bëj' botën plotë dora...; Nuk e ka shqiptari fisë / që të thith' nga dosa sisë!*; *E pra fjalën e ka Vlora / ta bëj' botën plotë dora...* (f. 133)

d. Njësitë frazeologjike në penën e Ali Asllanit japin me ngjyrimë semantike e emocionuese dhe probleme shoqërore. Fjala vjen, te poezia “Hakërrim” gjen më dhjetëra e dhjetëra njësi që marrin pjesë në shprehjen e mendimeve e të ndjenjave të autorit për intelektualin që revoltohet për shumë plagë të kohës. Poezia mbart mesazhe shumë domethënëse e të gjithëkohshme, sa në ditë e sotme janë më me vlerë se kurrë, apo thënë ndryshe, duket sikur Ali Asllani është i gjallë, sikur përjeton e shkruan për gjendjen e tanishme të Shqipërisë: *Që të zinit një kolltuk, aq u ulët u përkulët, / sa në pragun e armikut vajtët si kopil u ngulët!*; *Fshati digjet kurva krihet: As ju hahet, as ju pihet, vetëm titulli ju kihet... / Teksa fshat' i varfër digjet... kryekurva nis e krihet!*; *Sidomos ju dredharakë, ju me zemra aq të nxira, / ju dinakë, ju shushunja, ju gjahtar' në errësira! / Ç'na pa syri, ç'na pa syri!... Hunda juaj ku nuk hyri: / te i miri, te i ligu, te spiuni më i ndyri!*; *Edhe ju të robëruar, rob në dor' të metelikut, / fshini sofrat e kujtdoj', puthni këmbën e armikut!*; *Dhe u bëtë pasanikë, me pallate, me vetura, / kurse burrat më fisnikë japin shpirtin në tortura!*; *Vëndi qënka sofr' e qorrit, vlen për goj' e për lëfytë, / bëni sikur veni vetull', shoku shokut kreni sytë... / Dhe për një kërkoni pesë, po më mir' njëzet e pesë. / Le të rrojë batakçiu dhe i miri le të vdesë!* etj.

e. Dashuria është mbimotivi i poezisë lirike të A. Asllanit. Ndjenja për vajzën shqiptare, për bukurinë e saj fizike e shpirtërore është përbërës i pandashëm i krejt vëllimit dhe njësitë frazeologjike, këtu, më shumë se në çdo poezi tjetër, fitojnë

vlera të reja shënuese, konotative e stilistikore: *Në je ndonjë ëngjëll, udhën ke lajthitur, / apo sjell melhemin zembrës së goditur?*; *Kush të paska rritur, kush të ka selitur? / Trupi yt i bukur si flori i situr!*; *Në je ndonjë xhinde, xhinde e arratisur, / cilin ke vithisur, kujt i je kolisur?*; *Në je donjë hije, / hije hyjënore, / kthema zembrën time, / zembrën që ma more!*; *Gjithë jetën të këndova, të këndova pa u rresht', / meqë buza më ka plasur, e vendosa që të hesht, / dhe do heshtem deri sot, deri nesër, deri dej, / deri syri në lot regjur zjarr' e zembrës ta rrëfej!'; Aty shpirti dridhet, aty zemra hidhet, / aty rreth e rrotull lozën gugulidhet; / dhe për her' të parë po në atë vënd / një zogëz, një ...hajde, më rrëmbeu mënd!* etj.

Poezia, vargu, fjala në penën / në gojën e poetit, me vlagën vluese të poezisë popullore, dashuron, portretizon bukurinë, gëzon në shpirt, por gjithashtu ajo edhe tall, ironizon, sarkazmon. Roli i frazeologjisë për këtë është i pazëvendësueshëm: *Mirpo zonja është besnike, ka dhën' fjalën, ka bërë bé, / sa të thahet varri i burrit doemos do rrij' e vé, / me që varri është i freskët, është i njomë, është i ri, / që të thahet shpejt e shpejt, zonja Lu i bën veri!*; *Nga satrapët më satrap / nga dervishët më dervish, / ky zabit, ky dreko-lab, / pa kalem e pa qitap, / paskish lindur me këmish!* etj.

2. Në një prerje statistikore brenda një teksti / një poezie mund të themi se në vëllimin “Vidi-vidi pëllumbeshë!” të Ali Asllanit nuk asnjë syresh që të mos ketë të paktën një njësi frazeologjike. Ato mund të dalin të vetme në një varg e madje edhe në një strofë të tërë: **I ra pika: Edhe pika që më ra, që më ra e që më vrau, / i ra gurit dhe e çau, i ra drurit dhe e thau** (Mos më dua tashi e tutje, f. 27); **Ta do zëmra? I thua: eja! / Një çift kite na mjaftojnë / dhe në vjesht', kur varet reja, / dallandyshtet udhëtojnë.** (Dallandyshtet dhe vajzat, f. 28)

Por në poezinë e Ali Asllanit ndesh shumë shpesh që në një strofë mund të ketë edhe 2-3, madje edhe 4 njësi frazeologjike, si:

a. Strofë me 3 njësi frazeologjike: *njëra flet me vetull, tjetra me qepalle / valle deti valle, valle për shtat' qejfe, / s'paska më mir' valle, se këto me defë!* (f. 11).

b. Strofë me 4 njësi frazeologjike: *Natën vjen e bënet dritë, / bënet dritë e bënet yll, / mbi qepalle më trokitë, / s'më lë syrin që ta mbyll.* Natën vjen e bënet dritë, / bënet dritë e bënet yll, / mbi qepalle më trokitë, / s'më lë syrin që ta mbyll. (f. 21) *Folu, nuk të flasën; ktheu, zën e shkasën / dhe me cep të syrit din' se si të vrasën. / Dhe ajo që duket engjëllushë e butë / në një shishe brënda dy shejtane futë.* (f. 258).

3. Si u shprehëm më lart, poezia ka “kapriçiot” e veta dhe tek ajo sendërtohet më mirë se kudo pohimi se *letërsia është art i fjalës*. Por këto kapriçio mund të vërehen në përdorimin e frazeologjive, të cilat, në një tekst poetik sidomos, nuk dalin në trajtën përfaqësuese, që e identifikon atë si njësi e strukturës leksikore

a. Në materialin e analizuar, për efekte të ritmit e të rimës, gjen edhe ndërtime frazeologjike lehtësisht të verifikueshme dhe të gjetshme, si: *Hanko Halla isha, Hanko Halla jam / Hal' në sy i kisha, hal' në sy i kam. / Nuk më mbushet syri, nuk më mbushet zemra / nuk më piqet ylli me të tilla femra!* (f. 258).

Por në poezi mund të ketë edhe dy njësi frazeologjike që kanë një gjymtyrë të përbashkët. Njësia frazeologjike del e plotë vetëm te një ndërtim, kurse në tjetrin mungon njëra gjymtyrë, përgjithësisht gjymtyra që nuk është vatër semantike e

njesisë: **Bëhem palë / bëhem petëz:** *Un' poet i shkretëzë / bëhem pal' e petëzë, / kam një et, një zjarr po thua / dy her' zjarr një etëzë!* (f. 24).

b. Letërsia, sidomos poezia, kërkon aftësinë, zotësinë dhe mjeshtërinë më të lartë të përzgjedhjes së mjeteve të shprehjes dhe të përdorimit të tyre me art. Në këtë proces, ku gjen vend me peshë edhe frazeologjia, shumë shpesh ndodhin dy dukuri me kahe të kundërta:

b. 1. Për efekte stili, për ngjeshje të informacionit dhe të kondensimit semantik në poezinë e A. Asllanit, njësia frazeologjike mund të humbasë njërin nga gjymtyrët, duke mbetur në vargun poetik vetëm ajo gjymtyrë që mbart vatrën kryesore informative dhe konotative gjithë njësisë: **I bie pika:** *Gropëzat që, pika mua! / gotëza të mbushura prerë, / që t'i thith një her' si dua, / jam gati të vdes dy herë!* (f. 36)

b. 2. Dukuria tjetër, e kundërt me të parën, del si proces i zgjerimit të një njësie frazeologjike, si thyerje e kufizimit të saj strukturor, duke u futur midis gjymtyrëve të saj një a më shumë njësi të tjera, tashmë me funksion perifrazues, fillues, saktësues a aktualizues, madje edhe jo rrallë, edhe për plotësimin e masës metrike të vargut: **E fut në dhe të gjallë:** *Dhe këtu në dhë të gjallë dora jote të më fus', / që të rroj edhe i vdekur, të vazhdoj për ty të lus!* (f. 57).

c. Nga një herë njësia frazeologjike, për efekte të ndërtimit poetik, e prish strukturim dhe nga një njësi e strukturës leksikore-frazeologjike ajo kthehet në një ndërtim sintaksor frazor, me fjali kryesore dhe me fjali të nënrenditur: **Iu dogj zemra:** *Pyeta zoga, pyeta zogj / pyeta zemrën që m'u dogj.* (f. 15); Bëhet yll: *Natën vjen e bënet dritë, / bënet dritë e bënet yll, / mbi qepalle më trokitë, / s'më lë syrin që ta mbyll.* (f. 21); **E theri me sy:** *Shtatë kate paskish qielli, shtatë ngjyra ylyveri; / shtatëdhjet' e shtat' zjarre kishte syri që më theri!* (f. 67).

d. Dihet se një nga figurat e sintaksës poetike, me vlerë të fuqishme stilistikore, është inversioni, proces e dukuri që vërehen dhe te frazeologjia e përdorur nga poeti lirik A. Asllani. Prishja e rendit të gjymtyrëve fiton vlera emocionuese të dyfishta, sepse vetë frazeologjia e ka tipar kryesor ngjyrimin emocionues: **Si dritë e thyer në ujë:** *Pjesa ime një puqer / rrall' një vetull, rrall' një sy, / dhe si drita në uj' thyer / ca kujtime... gjer aty!* (f. 41)

4. Në frazeologjinë e qëmtuar në poezinë e këtij poeti gjejmë dukuri krahinore të të folmes jugperëndimore të shqipës, të asaj vlonjate, që mund të jenë dukuri dialektore morfologjike, fonetike etj.: Po japim vetëm një shembull: në poezi gati gjithandej gjejmë formën **bënet** / për **bëhet:** *Natën vjen e bënet dritë, / bënet dritë e bënet yll, / mbi qepalle më trokitë, / s'më lë syrin që ta mbyll.* (f. 21)

5. Në frazeologjinë e vjelë nga vëllimi “Vidi-vidi pëllumbeshë!” gjejmë dhe frazeologji që kanë në strukturën e vetë fjalë të huazuara:

a. Huazime nga turqishtja: Nuse me **duvak** / **xhevair me vandak::** *Këto lodra m'i ka ënda, / këto nuse me duvak, / ball' o ball' seç paske brënda / xhevair me vandak!; Për shtatë palë qejfe:* / *njëra flet me vetull, tjetra me qepalle, / valle deti valle, valle për shtat' qejfe, / s'paska më mir' valle, se këto me defel; Të shëron xhanin:* ... *Si veriu verës mu në mes të vapës / xhanin ta shëron*

Vlera artistike e frazeologjisë në poezinë e Ali Asllanit

zër' i njom i capës.; I bëj hallall: Porosita djalit: - Në se të kam djalë, / ik e i thuaj nuses të m'u bëjë hallallë!

b. Huazime nga greqishtja: **Ormis zemrën:** *Mu këtu, / ku ormisi zemrën zoti, / aty kam një gugufu / që e koj me pika loti.;* **I mahis zemrën:** *Ra mbi femra i pajisi, / ra mbi zemra i mahisi!;* **Iu bë farmak:** *Tani jam një plakëzë / shtatëdhjet' pa pakëz / dhe tani po atë dua / një diçka, një puthje hua / që m'u bëftë farmakëzë!*

6. Nëse kundrimi i njësive frazeologjike në poezinë e Ali Asllanit do të bëhej sipas vlerës së tyre leksiko-gramatikore, theksojmë se në grupin me rreth 650 njësi që kemi nxjerrë dhe që e kemi dhënë më poshtë, i gjen të gjitha llojet: njësi me vlerë emërore, mbiemërore, foljore dhe ndajfoljore.

Po ndalemi vetëm në disa njësi me vlerë foljore që tërheqin vëmendjen: tek ato që janë përdorur me pjesëza mohuese, duke shprehur një mohim gjuhësor / sintaksor. Mohimi në to nuk ngjizet si pjesë e strukturës semantike, çka vërtetohet dhe nga fakti se ato janë pranuar si njësi në kuptimin pohues. Ndërtim tjetër është thjesht një njësi me vlerë foljore me pjesëz mohuese para: **I zë besë:** *kur kam syt' e tu të zes / buzës sime s'i zë bes'!*; **Nuk më mbushet zemra:** *Hanko Halla isha, Hanko Halla jam, / Hal' në sy i kisha, hal' në sy i kam. / Nuk më mbushet syri, nuk më mbushet zemra, / nuk më piqet ylli me të tilla femra!;* **Më piqet ylli:** *Hanko Halla isha, Hanko Halla jam, / Hal' në sy i kisha, hal' në sy i kam. / Nuk më mbushet syri, nuk më mbushet zemra, / nuk më piqet ylli me të tilla femra! etj.*

Duke përfunduar këtëparashtrim tepër të shkurtër për disa veçori të frazeologjisë në veprën “Vidi-vidi pëllumbeshë” të Ali Asllanit, theksojmë edhe një herë, se synimi ynë, në këtë punim, më shumë ka qenë të analizojë me themel këtë pasuri të vlerësuar, por më shumë ta evidentojë atë si gjendje gjuhësore. Ndaj në vijim kemi sjellë një Fjalorth frazeologjik, me njësinë frazeologjike në formën përfaqësuese si fjalë titull dhe mandej me jetën në poezi të kësaj njësie frazeologjike. Për të mos e ngarkuar tekstin, nuk e pamë të arsyeshme të jepnim shpjegime kuptimore për këto njësi. Ato janë lehtësisht të zërthyeshme semantikisht, sepse, ndër të tjera thënie të ku ato janë përdorur, janë dhënë të plota.

Njësi frazeologjike të vjela nga vëllimi “Vidi-vidi pëllumbeshë!”

(Renditja nuk është alfabetike, por sipas faqeve të librit ku është gjetur njësia)

Gisht në sy: *Rrotull teje çdo kujtim, / tash që ndodhem larg nga ty, / vlen si vlen një vetëtim' / kur është nata gisht në sy!* (f. 9)

Me dorë të rëndë: *E kudo dhe kurdoherë / brohoris kujtimin tënd, / dhe kur dimri nëpër dyerë / trokëllin me dorë të rëndë!* (f. 9)

Më teptis zemra: *Se sa bukur ma qëndis / gjumin tim me atë ëndërr, / e un' mbushem e teptis, / më teptis e shkreta zemër!* (f. 9)

Ma ka ënda: *Këto lodra m'i ka ënda, / këto nuse me duvak, / ball' o ball' seç paske brënda / xhevair me vandak!* (f. 10)

Nuse me duvak: *Këto lodra m'i ka ënda, / këto nuse me duvak, / ball' o ball' seç paske brënda / xhevair me vandak!* (f. 10)

Xhevair me vandak: *Këto lodra m'i ka ënda, / këto nuse me duvak, / ball' o ball' seç paske brënda / xhevair me vandak!* (f. 10)

Flet me vetull: / njëra **flet me vetull**, **tjetra me qepalle**, / valle deti valle, valle për shtat' qejfe, / s'paska më mir' valle, se këto me defe! (f. 11)

Flet me qepallë: / njëra flet me vetull, **tjetra me qepalle**, / valle deti valle, valle për shtat' qejfe, / s'paska më mir' valle, se këto me defe! (f. 11)

Për shtatë palë qejfe: / njëra flet me vetull, **tjetra me qepalle**, / valle deti valle, valle **për shtat' qejfe**, / s'paska më mir' valle, se këto me defe! (f. 11)

Të shëron xhanin: ... Si veriu verës mu në mes të vapës / **xhanin ta shëron** zër' i njom i capës. (f. 11)

Si pikë e lotit majë qepallës: edhe vajza vetë në krye të valles / **mu si pikë lotit majave qepallës**. (f. 11)

(Ecën) mbi thonj të këmbës: Dy ato të parat dridhen e përdridhen / **hop, mbi thonj të këmbës**, din se si të hidhen. (f. 12)

Si flutura në flakë: Dor' për dor' të gjitha shoqet rreth përqarkë, / **cilado një flutur gati për në flakë** (f. 12)

E zbritur nga qielli: Dashuria, **tungjatjeta**, / midis çiftit të selitur / dhe me mbesën ton' të situr, është e ëmbël shumë e shkreta, / është gosti **nga qielli zbritur!** (f. 13)

Këmbejmë unazat: Dallandyshtet edhe vajzat / vinë e rrjedhin nga një derë, / në vjesht' shkojnë **këmbejn' unazat**, / kthehen çift në paraverë! (f. 14)

Iu dogj zemra: Pyeta zoga, pyeta zogj, / pyeta **zembrën që m'u dogj**. (f. 15)

Mollë e kuqe: Ku është **moll' e kuqe**, rreth e rrotull dete, / mollën do ta marr edhe ty për vete! (f. 18)

I ka hije: Atë lot, që **më ka hije**, / kur në këmb' të tua bije! (f. 19)

I bie ndër këmbë: Atë lot, që më ka hije, / **kur në këmb' të tua bije!** (f. 19)

I jap shije: Un' kam vjershën edhe pijen / po je ti, që **u jep shijen** (f. 19)

I zë besë: kur kam syt' e tu të zes / buzës sime s'i zë **bes'**! (f. 20)

Ormis zembrën: Ku **ormisi zembrën** zoti, / aty kam një guguftu, / që e koj me pika loti. (f. 21)

E koj me pika loti: Mu këtu, / **ku ormisi zembrën zoti**, / aty kam një guguftu, / që e koj me pika loti. (f. 21)

Bëhet dritë: Natën vjen e **bënet dritë**, / bënet dritë e bënet yll, / mbi qepalle më trokitë, / s'më lë syrin që ta mbyll. (f. 21)

Bëhet yll: Natën vjen e bënet dritë, / bënet dritë e **bënet yll**, / mbi qepalle më trokitë, / s'më lë syrin që ta mbyll. (f. 21)

Trokas mbi qepallë: Natën vjen e bënet dritë, / bënet dritë e bënet yll, / **mbi qepalle më trokitë**, / s'më lë syrin që ta mbyll. (f. 21)

Nuk mbyll syrin: Natën vjen e bënet dritë, / bënet dritë e bënet yll, / mbi qepalle më trokitë, / **s'më lë syrin që ta mbyll**. (f. 21)

Bëhem vetëtimë: Ditën **bënet vetëtimë** / e me krisma e me bujë, / shkrep në mes të shpirtit tim / dhe më prish, më bën rrëmuje. (f. 21)

Më shkrep në shpirt: Ditën bënet vetëtimë / e me krisma e me bujë, / **shkrep në mes të shpirtit tim** / dhe më prish, **më bën rrëmuje**. (f. 21)

Flas përçart: Iki larg e ngrihem lart / kaloj drit' e kaloj hije, / pastaj zë e **flas përçart** / dhe në këmb' të saja bije. (f. 21)

I bie te këmbët: Iki larg e ngrihem lart / kaloj drit' e kaloj hije, / pastaj zë e flas përçart / dhe **në këmb' të saja bije**. (f. 21)

Si hije nga pas: E kudo ajo vete / më tërheq **si hije pas**, / zot, o zot që s'jam në vete, / e humbas, humbas, humbas. (f. 22)

Nuk jam në vete: E kudo ajo vete / më tërheq si hije pas, / zot, o zot që **s'jam në vete**, / e humbas, humbas, humbas. (f. 22)

Si valë mbi zall: Dhe buças **si val' mbi zallë**, / kur buçet e kur dremet, / ajo vjen përher' vërdallë / mbi qepalle më trokit. (f. 22)

Vlera artistike e frazeologjisë në poezinë e Ali Asllanit

Vij vërdallë: *Dhe buças si val' mbi zallë, / kur buçet e kur dremit, / ajo vjen përher' vërdallë / mbi qepalle më trokit.* (f. 22)

Ta pish në kupë: *Çupëzë, moj çupëzë, / do t'të mbaj mbi supëzë, / në më do sa un' të dua, / do t'të pi në kupëzë!* (f. 23)

Ta pish në gotë: *Do t'të pi pi me gotëzë, / do t'të shtroj notëzë, / nëse vjen e pi me mua, / do t'të qaj me lotëzë!* (f. 23)

Të djegë si eshkë: *Zeshkëzë, moj zeshkëzë, / vogëlushe pjeshkëzë, / në më jep një puthje hua / do t'të djeg si eshkëzë!* (f. 23)

I jap një puthje hua: *Zeshkëzë, moj zeshkëzë, / vogëlushe pjeshkëzë, / në më jep një puthje hua / do t'të djeg si eshkëzë!* (f. 23)

I bë halë: *Valëzë, moj valëzë, / them ta them një fjalëzë, / as ta them e as ma thua / e mu bë një halëzë!* (f. 23)

Bëhem palë: *Un' poet i shkretëzë / bëhem pal' e petëzë, / kam një et, një zjarr po thua / dy her' zjarr një etëzë!* (f. 24)

Bëhem petë: *Un' poet i shkretëzë / bëhem pal' e petëzë, / kam një et, një zjarr po thua / dy her' zjarr një etëzë!* (f. 24)

Iu bë farmak: *Tani jam një plakëzë / shtatëdhjet' pa pakëz / dhe tani po atë dua / një diçka, një puthje hua, / që m'u bëftë farmakëzë!* (f. 25)

Vesh për vesh: *Zogu zogës do ja thot' / vesh për vesh me goj' të plot'.* (f. 26)

Me plot gojën: *Zogu zogës do ja thot' / vesh për vesh me goj' të plot'.* (f. 26)

I çaj zemrën: *"Mos më duaj tashi e tutje", mos më duaj... po si e qysh, / si ta çaj të vetmen zemër, si ta çaj ta bëj më dysh? (Mos më duaj tashi e tutje, f. 27)*

I bëj zemrën më dysh: *"Mos më duaj tashi e tutje", mos më duaj... po si e qysh, / si ta çaj të vetmen zemër, si ta çaj ta bëj më dysh? (f. 27)*

I ra pika: *Edhe pika që më ra, që më ra e që më vrau, / i ra gurit dhe e çau, i ra drurit dhe e thau* (f. 27)

Ma do zemra: Ta do zëmra? *I thua: eja! / Një çift kite na mjaftojnë / dhe në vjesht', kur varet reja, / dallandyshtet udhëtojnë.* (f. 28)

Këmbejmë unazat: *Dallandyshtet edhe vajzat / vinë e rrjedhin nga një derë, / në vjesht' shkojnë / këmben' unazat, / kthehen çift në pranverë!* (f. 28)

Rreze dielli nëpër shi: *Një magji, një hijeshi, / rrez' e diellit nëpër shi.* (f. 29)

E pajis femrën: Ra mbi femra i pajisi, / ra mbi zëmra i mahisi! (f. 29)

I mahis zemrën: *Ra mbi femra i pajisi, / ra mbi zëmra i mahisi!* (f. 29)

Si fajkua me sy çelur: *Si fajkua me sy çelur / rreth e rrotull nëpër hije, / ku ti zogëz veje vije, / ruaj vëndin ku ke shkelur!* (f. 31)

Për kokën tënde: *E ja -ja, për kokën tënde, / si një xhinde nëpër mure, / duke thithur një pagure, / kërkoj kohën që më çmende!* (f. 31)

Si një xhinde nëpër mure: *E ja -ja, për kokën tënde, / si një xhinde nëpër mure, / duke thithur një pagure, / kërkoj kohën që më çmende!* (f. 31)

Bëj be: *Bë për ty, për qiell për dhë, / dora ime kurdoherë / nëpër mure, nëpër dyerë / skalis emrin tënd, edhe.* (f. 31)

Për qiell e për dhe!: *Bë për ty, për qiell për dhë, / dora ime kurdoherë / nëpër mure, nëpër dyerë / skalis emrin tënd, edhe.* (f. 31)

Më plasi buzën: *Më plaç buzën pleqëri / që sa vete lëshon lule, / lëshon push të njom' mbi tule / dhe këndon si zog i ri!* (f. 31)

Lëshon lule: *Më plaç buzën pleqëri / që sa vete lëshon lule, / lëshon push të njom' mbi tule / dhe këndon si zog i ri!* (f. 31)

Iu thaftë dora!: *Mbase shkon e dëgjon ora, / mbase këthenet guguftuja... / si e lashë m'u thaftë dora! / guguftun' me shtatë tuja?* (f. 33)

Me shtatë tuje: *Mbase shkon e dëgjon ora, / mbase këthenet guguftuja... / si e lashë m'u thaftë dora! / guguftun' me shtatë tuja?* (f. 33)

Shkel mbi thua: Dikur bija, si fajkua, / shtek më shtek e në sinor, / duke **shkelur përmbi thua**, / ajo priste në oborr... (f. 33)

E bëj hasha: *Vishet mëni, çvishet vasha, / përgëzonet llër' e supa... / Un', moj xhane, s'e bëj' hasha, / më pëlqen t'ju pi me kupa!* (f. 34)

Vishet mani, zhvishet vasha (erdhi pranvera): **Vishet mëni, çvishet vasha**, / përgëzonet llër' e supa... / Un', moj xhane, s'e bëj' hasha, / më pëlqen t'ju pi me kupa! (f. 34)

Ta pish në kupë: *Vishet mëni, çvishet vasha, / përgëzonet llër' e supa... / Un', moj xhane, s'e bëj' hasha, / më pëlqen t'ju pi me kupa!* (f. 34)

I bie pas: Gjithë jetën **pas ju rashë** / Shtek në shtek e kënd më kënd, / midis ju dhe mua tash / dhe në linja s'ka më vënd! (f. 34)

Del nga brinja: Nuk ka mbetur vënd për linja, / lemni, pra, t'ju qaj me lot, / sepse femra **del nga brinja**, / urdhëron i madhi zot! (f. 34)

I vete zemrës kundër: Në të till' të holla punëra / unë u bëra palë e pet', / s'mund **t'i vete zemrës kundra**, / jam artist e jam poet! (f. 35)

I bie pika: Gropëzat që, **pika mua!** / gotëza të mbushura prerë, / që t'i thith një her' si dua, / jam gati të vdes dy herë! (f. 36)

Gotëz e mbushur prerë: Gropëzat që, pika mua! / **gotëza të mbushura prerë**, / që t'i thith një her' si dua, / jam gati të vdes dy herë! (f. 36)

Vdes dy herë: Gropëzat që, **pika mua!** / gotëza të mbushura prerë, / që t'i thith një her' si dua, / jam gati të vdes dy herë! (f. 36)

I bëj barmish: Do t'i ysht **t'i bëj barmish**, / do t'i bëj fitil për zemër, / do të prishem dhe do të prish / dhe do bëj të bëhem emër! (f. 36)

I bëj fitil për zemër: Do t'i ysht t'i bëj barmish, / do **t'i bëj fitil për zemër**, / do të prishem dhe do të prish / dhe do bëj të bëhem emër! (f. 36)

Bëhem emër: Do t'i ysht t'i bëj barmish, / do t'i bëj fitil për zemër, / do të prishem dhe do të prish / dhe do bëj të bëhem emër! (f. 36)

I humbi mendja: Era vjen me duf si plumbi / dhe nuk le folë në vënd, / dallandyshta ime humbi / edhe unë i **humba mënd!** (f. 38)

Ka dasmë merimanga: Kur bën koha diell e shi / **merimanga paska dasëm**, / s'di, për zotin, po tashi / **un' dhe zemra ime shkasëm!** (f. 39)

Më shket zemra: Kur bën koha diell e shi / merimanga paska dasëm, / s'di, për zotin, po tashi / **un' dhe zemra ime shkasëm!** (f. 39)

Më vete mendja: **Mëndja vete ku nuk vihet...** / e më tej, e më përtej... / një pullumb që di e ngrihet / ai di se ku do vej! (f. 39)

Vete mendja e shkretë: **Ku nuk vete mëndj' e shkretë** / bënet shkum dhe mbi tallas, / un' po varem tatëpjetë... / ajo shkon e shikon pas! (f. 39)

Më bëhet mendja shkumë: **Ku nuk vete mëndj' e shkretë** / **bënet shkum dhe mbi tallas**, / un' po varem tatëpjetë... / ajo shkon e shikon pas! (f. 39)

Gojë për gojë: Pranvera me bilbila / koha qesh dhe buza qesh, / diçka thon' për trëndafila / **goj' për gojë** e vesh për vesh! (f. 40)

Hedh sytë: Pjesa ime tepër pakë: / pi dy pika, **heth një sy**, / mezi marr një pikëz flakë / sa për zemër... gjer aty! (f. 40)

Marr flakë: Pjesa ime tepër pakë: / pi dy pika, heth një sy, / mezi **marr një pikëz flakë** / sa për zemër... gjer aty! (f. 40)

Marr sa për zemër: Pjesa ime tepër pakë: / pi dy pika, heth një sy, / mezi marr një pikëz flakë / **sa për zemër...** gjer aty! (f. 40)

Bëj sedef: Thon' se shiu muajt maj / nëpër dete **bën sedefe** / dor' e vajzës punon paj', / dor' e majit bën gjergjefe! (f. 40)

Dorë e majit: Thon' se shiu muajt maj / nëpër dete **bën sedefe** / dor' e vajzës punon paj', / **dor' e majit** bën gjergjefe! (f. 40)

Vlera artistike e frazeologjisë në poezinë e Ali Asllanit

- Bëj gjergjef:** *Thon' se shiu muajt maj / nëpër dete bën sedefe / dor' e vajzës punon paj', / dor' e majit bën gjergjefe!* (f. 40)
- Bejkë e stanit:** *Erdhi vera përsëri / kalipeç mbi shtiza dielli, / bejk' e stanit buz' flori / del e pret me kënga fyelli!* (f. 41)
- Si dritë e thyer në ujë:** *Pjesa ime një puqer / rrall' një vetull, rrall' një sy, / dhe si drita në uj' thyer / ca kujtime... gjer aty!* (f. 41)
- Çel buzën:** *Dikur çelet buzë e gjorë / me një mbase, me një mund... / mu si lulja nënë borë / kurse era vjen e shkund!* (f. 43)
- Si lulja nën borë:** *Dikur çelet buzë e gjorë / me një mbase, me një mund... / mu si lulja nënë borë / kurse era vjen e shkund!* (f. 43)
- Sjell melhem për zemrën e goditur:** *Në je ndonjë ëngjëll, udhën ke lajthitur, / apo sjell melhemin zemrës së goditur?* (f. 44)
- Si flori i situr:** *Kush të paska rritur, kush të ka selitur? / Trupi yt i bukur si flori i situr!* (f. 44)
- Xhinde e arratisur:** *Në je ndonjë xhinde, xhinde e arratisur, / cilin ke vithisur, kujt i je kolisur?* (f. 44)
- Hije hyjnore:** *Në je donjë hije, / hije hyjnore, / kthema zemrën time, / zemrën që ma more!* (f. 45)
- I kthej zemrën:** *Në je donjë hije, / hije hyjnore, / kthema zemrën time, / zemrën që ma more!* (f. 45)
- I marr zemrën:** *Në je donjë hije, / hije hyjnore, / kthema zemrën time, / zemrën që ma more!* (f. 45)
- E kam marrë (e kam futur) në zemër:** *Për atë, për aq për kaq, / më ke marrë në zemër paq!* (f. 47)
- Më ka marrë malli:** *Është një mall i thellë i shkret' / që në zemër më ka marr'!* (f. 49)
- Mbush kupa, zbras kupa:** *Gjith ditën kupa mbush / gjithë natën kupa zbras!* (f. 49)
- Më digjet zëmra:** *Zëmra digjet ylyver, / mendja vete asaj pas!* (f. 49)
- Më vete mendja:** *Zëmra digjet ylyver, / mendja vete asaj pas!* (f. 49)
- S'jam në vete:** *Plaça un' që s'jam në vete; / plaça un' që prishem mend* (f. 49)
- Prishem nga mendtë:** *Plaça un' që s'jam në vete; / plaça un' që prishem mend* (f. 49)
- Trëndafil imbirë me hënë:** *Atë gjë që ty të bënë / trëndafil të mbir' me hënë!* (f. 53)
- Zbret zogjtë nga fluturimi:** *Një vështrim, një këngë vështrimi, / që zbret zogjtë nga fluturimi!* (f. 53)
- Ylli që bie në ujë:** *Nuk je ti që ishe dije, / ai yll që në uj' bie.* (f. 53)
- I jap buzën:** *Buzën time do t'ta jap, / hënë e ngrënë, bëhet prap'.* (f. 54)
- Hënë e ngrënë:** *Buzën time do t'ta jap, / hënë e ngrënë, bëhesh prap'.* (f. 54)
- Më mbushen sytë:** *Se kur ti më puth në sy, / sytë më mbushen që të dy!* (f. 54)
- Nga një vesh më hyn, nga tjetri më del!** *Fllad i freskët fryn / dhel e përkëdhel, / nga një vesh më hyn / nga një vesh më del!* (f. 55)
- I është mbrujtur shpirti me zjarr:** *Flladi paska frytur / ler' të jap, të marr, / shpirti im ish mbrujtur / tej për tej me zjarr!* (f. 55)
- Mjaltë i bardhë në hoje:** *Ku si bleta, zoga bletë, që fsheh mjaltin nëpër hoje, / kemi fshehur lotët tanë dy her' mjalt i bardhë në hoje, / lotët tanë, që tashti unë, duke qar' me ngashërim, / i kërkoj si bar shërimi për një plag', që s'ka shërim!* (f. 56)
- Bar shërimi:** *Ku si bleta, zoga bletë, që fsheh mjaltin nëpër hoje, / kemi fshehur lotët tanë dy her' mjalt i bardhë në hoje, / lotët tanë, që tashti unë, duke qar' me ngashërim, / i kërkoj si bar shërimi për një plag', që s'ka shërim!* (f. 56)
- Nuk ka shërim:** *Ku si bleta, zoga bletë, që fsheh mjaltin nëpër hoje, / kemi fshehur lotët tanë dy her' mjalt i bardhë në hoje, / lotët tanë, që tashti unë, duke qar' me ngashërim, / i kërkoj si bar shërimi për një plag', që s'ka shërim!* (f. 56)
- E fut në dhe të gjallë:** *Dhe këtu në dhë të gjallë dora jote të më fus', / që të rroj edhe i vdekur, të vazhdoj për ty të lus!* (f. 57)

I zien në zemër diçka: Ty në zemër diç të zjen e i ul ato qepalle, / ato syskëza qepalle të radhitur' si në valle... (f. 57)

Zjarr në kraharor: Kam një zjarr në kraharuar për atë që s'qem na bëri! / E ky zjarr i grumbulluar më jep vrapin e një zëri! (f. 58)

I jap vrapin e zërit: Kam një zjarr në kraharuar për atë që s'qem na bëri! / E ky zjarr i grumbulluar më jep vrapin e një zëri! (f. 58)

Tel i thyer: Thon për mua, tel i thyer, / thon' për ty flori përherë. (f. 59)

Si e tjerrja nuk e tjerrë: Thon' për mua, tel i thyer, si e tjerrja nuk e tjerrë. (f. 59)

Njëmijë e një lule: Njëmijë e një lule, njëmijë e një çupa, / njëmijë e një zoga për të pir' në kupa! (f. 60)

Është për t'u pirë në kupë: Njëmijë e një lule, njëmijë e një çupa, / njëmijë e një zoga për të pir' në kupa! (f. 60)

Një pik' prushi në një natë: Një pik' prushi në një natë / me miliarda vjet e gjatë. (f. 62)

Me miliarda vjet e gjatë: Një pik' prushi në një natë / me miliarda vjet e gjatë. (f. 62)

Iu bëfsha kurban: Atë sy dhe atë vetull... / dhe m'u bëft kurban një shekull! (f. 63)

U bë fusha mal: Bot' e ré kjo, tungjatjeta, / edhe fusha u bë mal, / shkon përpjet' e tatëpjeta / mali e fusha u bën' pal'! (f. 64)

Shkon përpjet' e tatëpjeta: Bot' e ré kjo, tungjatjeta, / edhe fusha u bë mal, / shkon përpjet' e tatëpjeta / mali e fusha u bën' pal'! (f. 64)

Bëhem palë: Bot' e ré kjo, tungjatjeta, / edhe fusha u bë mal, / shkon përpjet' e tatëpjeta / mali e fusha u bën' pal'! (f. 64)

Bëhet byk në lëmë: Rrymë e frymë farmak çakalli, / fund e krye duhen çdukur, / ndryshe bëhet byk në lëmë / tejprtej kjo botë e bukur! (f. 66)

Zjarri i zemrës: Mbeti vetëm zjarri zemrës, edhe vajza këng' shëndeti / dy shkundi eterniteti. (f. 67)

I rënë prej së larti: Që i qofshim fal' edhe / Trup' i vajzës gosti qielli prej së larti rar' përdhe! (f. 67)

Këngë shëndeti: Mbeti vetëm zjarri zemrës, edhe vajza këng' shëndeti, / dy shkundi eterniteti! (f. 67)

I qofsha falë: Mbeti vetëm zjarri zemrës, edhe vajza këng' shëndeti, / dy shkundi eterniteti, / që i qofshim fal' edhe / Trup' i vajzës gosti qielli prej së larti rar' përdhe! (f. 67)

Gosti qielli: Mbeti vetëm zjarri zemrës, edhe vajza këng' shëndeti, / dy shkundi eterniteti, / që i qofshim fal' edhe / Trup' i vajzës gosti qielli prej së larti rar' përdhe! (f. 67)

Ka rënë nga lart (nga qielli): Mbeti vetëm zjarri zemrës, edhe vajza këng' shëndeti, / dy shkundi eterniteti, / që i qofshim fal' edhe / Trup' i vajzës gosti qielli prej së larti rar' përdhe! (f. 67)

Buk' e krip: Buk' e krip e në shtëpi, / mjalt në goj' e zjarr në zemër, dy her' puth e një her' pi! (f. 67)

Kam një zjarr në zemër: Buk' e krip e në shtëpi, / mjalt në goj' e zjarr në zemër, dy her' puth e një her' pi! (f. 67)

Mjalt në gojë: Buk' e krip e në shtëpi, / mjalt në goj' e zjarr në zemër, dy her' puth e një her' pi! (f. 67)

E theri me sy: Shtatë kate paskish qielli, shtatë ngjyra ylyveri; / shtatëdhjet' e shtat' zjarre kishte syri që më theri! (f. 67)

Nga një buzë në tjetrën: Dhe ky zjarr në mosh' të njomë s'di si niset, si koliset, / nga një buzë në buzën tjetër befaz puthja arratiset. (f. 67)

Mosha e njomë: Dhe ky zjarr në mosh' të njomë s'di si niset, si koliset, / nga një buzë në buzën tjetër befaz puthja arratiset. (f. 67)

Gjysma e mijës pesëqind: Aty thyhet, aty theket, trup' i vajzës vjen e zeshket, / Gjysm' e mijë pesëqintë, bën si do dhe si i teket (f. 67)

Më ndizet zemra: Hop në uj' e hop në kum, / nëpër trupa të freskuar zemra ndizet dhe më shumë... (f. 67)

Vlera artistike e frazeologjisë në poezinë e Ali Asllanit

Më zuri halli: Zemra ndizet dhe, dikuri, / diç i thonin njëri tjetrit **sipas hallit që na zuri!** (f. 67)
Plastë syri i keq! Po që syr' i keq të plas' edhe hasmi të pëlccas, / ish nevoj' të kapërxejmë përmbi krye tre tallas, / dhe nga tre tallas' të tjerë merrnin uj' me duar-tas. (f. 68)
Kapërcej tri tallaze: Po që syr' i keq të plas' edhe hasmi të pëlccas, / ish nevoj' të kapërxejmë përmbi krye tre tallas', / dhe nga tre tallas' të tjerë merrnin uj' me duar-tas. (f. 68)
Çdo të bardh' e bën të zezë: Çdo të bardh' e bën të zezë, çdo të zezë, më të zezë, / na i plasi sy e zemra, po sa nisën e u ndezë. (f. 73)
E bën çdo të zezë, më të zezë: Çdo të bardh' e bën të zezë, çdo të zezë, më të zezë, / na i plasi sy e zemra, po sa nisën e u ndezë. (f. 73)
Na i plasi syri: Çdo të bardh' e bën të zezë, çdo të zezë, më të zezë, / na i plasi sy e zemra, po sa nisën e u ndezë. (f. 73)
Na plasi zemra, Çdo të bardh' e bën të zezë, çdo të zezë, më të zezë, / na i plasi sy e zemra, po sa nisën e u ndezë. (f. 73)
Shih me sy e plas me zemër! Emri tij bosh një emër / **shih me sy e plas me zemër!** (f. 74)
Saksi e vjetër: Un' jam un', **saksi e vjetër!** / Lule gjirit që stolisa / shkoi stolisi një gji tjetër. (f. 76)
Duron zemra: Po u bë ajo që s'bënej, si, pra, **zemra do duroj'**, / syri lotin ta qëndisë, loti syrin ta harroj? (f. 76)
Më ka plasur buza: Gjithë jetën të këndova, të këndova pa u rresht', / meqë buza më ka plasur, e vendosa që të hesht, / dhe do heshtem deri sot, deri nesër, deri dej, / deri syri në lot regjur **zjarr'** e zemrës ta rrëfej'! (f. 77)
I regjur në lot: Gjithë jetën të këndova, të këndova pa u rresht', / meqë buza më ka plasur, e vendosa që të hesht, / dhe do heshtem deri sot, deri nesër, deri dej, / deri syri në lot regjur **zjarr'** e zemrës ta rrëfej'! (f. 77)
Zjarri i zemrës: Gjithë jetën të këndova, të këndova pa u rresht', / meqë buza më ka plasur, e vendosa që të hesht, / dhe do heshtem deri sot, deri nesër, deri dej, / deri syri në lot regjur **zjarr'** e zemrës ta rrëfej'! (f. 77)
Iu përvëlua zemra: Dikur syri flet më parë dhe nga buza më e çarë, / kurse zemra përvëlonet, syri ballit kullon **zjarr.** / Dhe ky **zjarr** që nuk është' **zjarr**, dy her' **zjarr**, një **zjarr** i madh, / djeg dhe yjet nëpër qieje, pasandaj i heq zvarr... (f. 77)
Më kullon syri zjarr: Dikur syri flet më parë dhe nga buza më e çarë, / kurse zemra përvëlonet, syri ballit **kullon zjarr.** / Dhe ky **zjarr** që nuk është' **zjarr**, dy her' **zjarr**, një **zjarr** i madh, / djeg dhe yjet nëpër qieje, pasandaj i heq zvarr... (f. 77)
Djeg dhe yjet nëpër qiell: Dikur syri flet më parë dhe nga buza më e çarë, / kurse zemra përvëlonet, syri ballit kullon **zjarr.** / Dhe ky **zjarr** që nuk është' **zjarr**, dy her' **zjarr**, një **zjarr** i madh, / djeg dhe yjet nëpër qieje, pasandaj i heq zvarr... (f. 77)
E heq zvarrë: Dikur syri flet më parë dhe nga buza më e çarë, / kurse zemra përvëlonet, syri ballit kullon **zjarr.** / Dhe ky **zjarr** që nuk është' **zjarr**, dy her' **zjarr**, një **zjarr** i madh, / djeg dhe yjet nëpër qieje, pasandaj i heq zvarr... (f. 77)
Bëj gazepe: Besabesa **bën gazepe**, e loti im sidomos / Me **zjarr** nis e me **zjarr** sos. (f. 77)
Dora e verës: Ish një val' mbi sup të erës, / ish një fllad e ish një flutur, / ish ajo që **dor' e verës** / nëpër lule e kish futur! (f. 78)
Var buzët: Nashti rroj po ja si rroj: / kur shkojn' vajzat bukuri / i vështroj e i vështroj, / heq kapellën e nderoj, / **varur buzë edhe turi!** (f. 81)
Var turinjtë: Nashti rroj po ja si rroj: / kur shkojn' vajzat bukuri / i vështroj e i vështroj, / heq kapellën e nderoj, / **varur buzë edhe turi!** (f. 81)
